



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilapen/Predatu Received/Deliverty	12. 08. 2022	viti god year	2
Organ /Rjeshta Organ /Zjedimca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHM	4685/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.620/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.620/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____ kundër organit të punësimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.620/2022 e datës 15.07.2022, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ Kordinator i Zyres Regjionale në Mitrovicë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 15.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4139/2022 të regjistruar me numër A.nr.620/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 2144/2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e Zëvendësuesit të Kryeshëfit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli me datë 04.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4139/2022 të regjistruar me numër A.nr.620/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.07.2022; Rregullorja Nr.03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; rregullorja Nr.05/2010 për Organizimin dhe



Fushëveprimin e Këshillit Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; Rregullorja QRK-Nr.29/2013 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; Rregullorja Nr.01/2011 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimi i datës 10.08.2020 i Qeverisë së Kosovës; E-mail zyrtar i datës 11.08.2021; Vendimit me numër protokolli 2143/2021 të datës 27.08.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; vendimit me numër protokolli 2144/2021 i datës 27.08.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 04.08.2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezultoi se ankuesi në bazë Vendimit me numër 01-320/2018 të datës 05.09.2018 është konstatuar se ankuesi nga pozita Kordinator i Zyres Regjionale në Prishtinë është transferuar si Kordinator i Zyres Regjionale në Mitrovicë në kuadër të të njëjtës kategori funksionale dhe gradë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kërkon të shfuqizohet vendimi me numër protokolli 2144/2021 i datës 27.08.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe kthehet nëpunësi civil N.K ne pozitën e Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."*, Kolegji vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.620/2022 e datës 15.07.2022, e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.620/2022, datë 11.08.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi Bajraktari

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

